



Buletini



Mars 2023



Mbi 1.8 milion euro vlera e Grantit të Performancës që u nënshkrua nga Kryetari z. Imri Ahmeti Në një ceremoni të organizaur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL.

Kryetari Ahmeti ka pranuar çmimin e dytë të Grantit të Performancës Komunale për vitin 2021, ku nga kjo renditje Komuna e Lipjanit ka fituar grant në vlerë prej 1,843,786.22 euro.



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z.Imri Ahmeti, me bashkëpunëtorët e tij janë takuar me z.Enrique Botero, Drejtor i projektit të USAID “Integriteti i Komunave të Kosovës” dhe përfaqësues të tjerë të USAID-it nga ky projekt, të cilët prezantuan rezultatet e arritura nga Komuna e Lipjanit për vitin 2022 në indikatorët e gradimit për komunat partnere.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti me bashkëpunëtorë, për nder të 25 vjetorit të Epopesë së Lavdishme të UÇK - së kanë bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta lulesh pranë shtatores së Komandantit Legjendar Adem Jashari.

Kryetari Imri Ahmeti, tha se marsi do të mbetet i shënuar në historinë e Kombit shqiptarë, data të cilat ndër vite do reflektojnë qëndresën e Komandantit Adem Jashari dhe sakrificën e familjes së tij për liri dhe pavarësi.

Përrulje përjetësisht për heroizmin dhe sakrificën e Familjes Jashari!

Lavdi!



Komuna e Lipjanit ndan mirënjuhje për mësimdhënësit e dalluar

Për nderë të 7 Marsit-Ditës së Mësuesit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan, ka organizuar ceremoninë e zgjedhjes së punëtorit të dalluar të vitit 2023, me ç'rast janë ndarë mirënjuhje edhe për mësimdhënësit e dalluar në secilën shkollë.



Nënshkruhen kontratat me përfituesit nga Komuna e Lipjanit në projektin INTEGRA

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti së bashku me përfaqësueset e Fondacionit për Zhvillim të Qëndrueshëm Ekonomik – PREDA Plus kanë pritur përfituesit nga projekti “INTEGRA - Nxitja e riintegritimit të qëndrueshëm lokal të grave, të rinjve dhe njerëzve të cënueshëm lokal në Kosovë”, të cilët njëherësh nënshkruan edhe kontratat për fillimin e start – up bizneseve të tyre.



Inaugurohet “Këndit i Kurajos”, në Komunës e Lipjanit

Kryetari Imri Ahmeti së bashku me drejtoreshën e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas, Kadire Tahiraj, kryesuesen e Grupit të Grave në Lipjan, Hyra Bytyçi dhe Ambasadoren e NDI, Nancy Soderberg në Ditën Ndërkombëtare të Gruas kanë inauguruar “Këndin e Kurajos”, në hapësirën e Komunës së Lipjanit.

Kryetari Imri Ahmeti, gjatë kësaj ceremonie tha se ndjehet mirë që Lipjani është ndër komunat e para që po ndanë një hapësire për vendosjen dhe promovimin e “Këndit të Kurajos”, një projekt ky i cili nëpërmjet punimeve te dorës ka për qëllim të përçojë mesazhin se edhe përkundër vuajtjeve dhe sakrificave, gratë nga vendi ynë kanë gjetur forcë dhe kurajo për ta vazhduar jetën.




Nënkryetari për komunitete Lulzim Qerimi, ka zhvilluar një takim pune me përfaqësuesit e programit Romacted të financuar nga Këshilli i Evropës, Sakibe Jashari dhe Besim Shkullolli të shoqëruar nga Maksut Gashi përfaqësues i Organizates "All youth together"- të gjithë të rinjtë së bashku.

Gjatë këtij takimi është biseduar për thellimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm në mes Komunes së Lipjanit- Programit Romacted dhe organizatës "All youth together", ku palët u dakorduan që së shpejti të fillojnë punimet në rregullimin e parkut në fshatin Medvec i cili do bashkëfinancohet nga Komuna e Lipjanit dhe programi- Romacted.



FOTOLAJM/Drejtori për Infrastrukturë, Sead Aliu ka vizituar punimet që po zhvillohen në kuadër të projektit “Rregullimi i Infrastrukturës në Janjevë”.



Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti, ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde.

Gjatë këtij takimi kanë diskutuar për çështje të ndryshme, me theks të veçantë për nxitjen e zhvillimit ekonomik në Komunën e Lipjanit dhe funksionimin e shërbimeve publike.

Kryetari Imri Ahmeti, ka shprehur mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të shtetit gjerman ndaj Kosovës, duke theksuar nevojën e një bashkëpunim të tillë edhe në të ardhmen.

Nga ana tjetër, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Joern Rohde, ka falenderuar Kryetarin Ahmeti, për mirëpritjen që i është bërë gjatë vizitës në Komunën e Lipjanit.

Ndërsa, në fund të këtij takimi u ritheksua edhe një herë gatishmëria për thellimin e bashkëpunimit të mëtutjeshëm.



Shpërndahen 300 pako ushqimore për familjet në nevojë

Komuna e Lipjanit së bashku me Organizatën Qatar Charity kanë shpërndarë 300 pako ushqimore për familjet me nevojë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, ka falenderuar Organizatën Qatar Charity për këtë ndihmë të nevojshme, e cila do t'ju shpërbej familjeve me vështirësi ekonomike pasi që jemi edhe në prag të muajit të Ramazanit.



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, Diamant Bytyqi dhe drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, Anila Reçica Llugiqi, kanë marrë pjesë në garat Regjionale (Regjioni i Ferizajit) të Basketbollit të cilat u zhvilluan në Qendrën Sportive dhe Arsimore “Beter Life”, në Lipjan.



Në Komunën e Lipjanit u mbajt tryezë diskutimi me Grupin e Grave të nivelit lokal të Lipjanit dhe Grupin e Grave të nivelit lokal të Obiliqit, ku njëherit u bë edhe shkëmbimi i praktikave të mira në mes këtyre dy grupeve.

Me këtë rast, nënkryetari i komunës Diamant Bytyqi, tha se Komuna e Lipjanit me përkushtim të veçantë ka mbështetur rolin e gruas lipjanase përmes aktiviteteve të ndryshme si dhe çdo nisme të inicuar nga Grupi Grave në Lipjan.



Mbahet mbledhja e rregullt e KKSB-së

Gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit ishte temë diskutimi në takimin e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) që u zhvillua gjatë muajit mars në sallën e takimeve, kryesuar nga nënkryetari i Komunës z. Diamant Bytyqi.

Në këtë takim, nënkryetari Bytyqi tha se gjendja e sigurisë në Komunën e Lipjanit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile dhe se duhet angazhim maksimal i të gjithëve që kjo situatë e mirë të vazhdoj edhe më tutje. Ai po ashtu ka njoftuar të pranishmit se në ditët në vijim do të publikohet edhe ftesa për nominimin e anëtarëve të disa komuniteteve për plotësimin e vendeve vakante në KKSB, për tu proceduar pastaj në Kuvendin e Komunës propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarëve të KKSB-së.



Përkrahje e Aktivitetit një kartolinë për ty nga shkollat e Komunës së Lipjanit për Down Sindrom Kosova
6 Shkolla nga Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit për nder të ditës ndërkombëtare të fëmijëve me Down Sindrom kanë mbështetur aktivitetin për mbështetjen e komunitetit të Sindromes Down në aktivitetin "Një kartolinë për ty".

NJË KARTOLINË PËR TY



DOWN
SYNDROME
KOSOVA

www.downsyndromekosova.org

DELEGACIONI I ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE PO PËRFAQËSON KOSOVËN NË PUNIMET E KONGRESIT TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti në cilësinë e nënkryetarit të Asociacionit të Komunave të Kosovës ka qëndruar në Strasburg, ku së bashku me kryetarin e AKK, Agim Aliu dhe drejtorin e AKK, Sazan Ibrahimimi kanë përfaqësuar Republikën e Kosovës në punimet e Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.



Komiteti për Komunitete ka mbajtur mbledhjen e radhës udhëhequr nga kryesuesi i Komitetit Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan pikat të cilat ishin të propozuara për rend të ditës.

Gjatë kësaj mbledhje u prezantuan informata nga Qendra për Punë Sociale në Lipjan lidhur me numrin e rasteve sociale nga komunitetet Rom, Ashkali, Kroat dhe Serb. Po ashtu u bë edhe prezantimi i raportit mujor të punës së Zyrës Lokale për Komunitete (ZLK-së).



Këshilla Juridike falas për qytetarët e Komunës së Lipjanit

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Komunës së Lipjanit dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas dhe GIZ-it gjerman si bashkëfinancues, po vazhdon punën zyra për ofrimin e shërbimeve juridike falas për qytetarët e komunës sonë.



Nënkryetari Bytyqi priti në takim të rinjtë e organizatës YAHR

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi ka pritur në takim të rinjtë e organizatës Youth Association for Human Rights – YAHR, udhëhequr nga drejtori i organizatës z. Bekim Krasniqi, me të cilët ka diskutuar rreth aktivizimit rinor në Lipjan.

Nënkryetari Bytyqi, ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm forcimin e bashkëpunimit në mes të pushtetit lokal dhe të rinjve, andaj ka inkurajuar ata që të jenë sa më aktiv përmes realizimit të projekteve të ndryshme për të avancuar agjendën e rinisë.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti me bashkëpuntorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vënë kurorë lulesh pranë pllakës përkujtimore të Heroit të Kombit, Ismet Asllani, me rastin e 24 vjetorit të rënies së tij.

“Idealet e Ismetit e të shokëve të tij për një shtet të prosperuar e zhvilluar janë detyrim dhe inspirim i përherëshëm i gjithë neve”, është shprehur kryetari Ahmeti.

Lavdi Heroit Ismet Asllani – Prapashtica!



Me qëllim të krijimit të qasjes së barabart të të gjithë personave, duke përfshirë edhe personat e verbër dhe të pamurit e dobësuar, Komuna e Lipjanit me përkrahje të organizatës People in Need (PIN), është ndër Komunat e para që ka filluar ofrimin e shërbimeve me printer brail.

Përmes këtij printeri personat e verbër dhe personat me të pamurit e dobësuar mund t'i kryejn shërbimet administrative komunale, e po ashtu të marrin informata nga drejtorati i shëndetësisë dhe nga Qendra për Punë Sociale.

Gjithashtu me përkrahje të organizatës PIN, së fundmi është zhvilluar edhe platforma dixhitale, një detabazë kjo e përbashkët për identifikimin dhe dokumentimin e të gjitha grupeve të ndjeshme dhe shërbimeve që pranojnë këta persona.



KPF zhvilloi punimet e mbledhjes së 14-të me radhë

Në sallën e takimeve në Komunën e Lipjanit është mbajtur mbledhja e 14-të e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF).

Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Daut Azemi, përveç pikave të parapara për këtë mbledhje, me propozim nga ekzekutivi ka propozuar tri pika shtesë për rendin e ditës.

Pas këtij ndryshimi, anëtarët e KPF-së, kanë shqyrtuar të gjitha pikat e rendit të ditës dhe i kanë rekomanduar për seancën e radhës të Kuvendit të Komunës që mbahet më 31 mars 2023.



Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit për fuqizimin ekonomik mes Komunës së Lipjanit dhe Help

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti dhe përfaqësuesi i organizatës "Help-Hilfe zur Selbsthilfe", z. Rrezart Shala kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të zbatimit të projektit "Përfshirja dhe Fuqizimi Ekonomik në Ballkanin Perëndimor", i financuar nga qeveria gjermane dhe zbatuar nga Help.

Në kuadër të këtij projekti do të përkrahen së paku 20 përfitues në qëllimet e tyre për fillimin apo zhvillimin e aktivitetit biznesor, duke dhuruar pajisje, organizimin e trajnimeve të biznesit dhe trajnimeve të tjera profesionale sipas nevojave të klientëve, si dhe monitorim dhe mbikëqyrje, me qëllim të zhvillimit të tyre të qëndrueshëm.



Mbahet mbledhja e 17-të e Kuvendit Komunal të Lipjanit


Udhëhequr nga Kryesuesi, Daut Azemi, Kuvendi i Komunës së Lipjanit ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 17-të me radhë, në të cilën me shumicë votash u aprovuan të gjitha pikat e rendit të ditës me tre pika të tjera shtesë.

Kryetari Imri Ahmeti, së bashku me drejtorët e drejtorateve komunale edhe gjatë kësaj seance kanë dhënë sqarime në të gjitha çështjet dhe pyetjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Gjatë punimeve të kësaj seance janë shqyrtuar dhe aprovuar këto pika të rendit të ditës:



Komuna e Lipjanit - Zyra për informim



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr: 28 14000 Lipjan, Kosovë